



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2016

SESIONI I

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Varianti B

Lënda: Gjuhë shqipe dhe Letërsi

Profesionale, artistike, sportive, me kohë të shkurtuar

PJESA I

*Komunikimi*

Pyetja 1	A	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	C	1 pikë
Pyetja 5	C	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	C	1 pikë

Pyetja 8                    2 pikë

**Argumenti I:** Zëri elektronik është më i pëlqyer se zëri njerëzor. Shembull: Kur bie celulari, bashkëbiseduesi nuk është më pjesë e bisedës.

Shembull: Shoferi që i detyroi të mbyllnin gojën.

**Argumenti II:** Përparimi i teknologjisë kthehet në pengesë për miqësinë mes njerëzve.

Shembull: imaillet, mesazhet në sekretarinë telefonike.

**Argumenti III:** Automatizimi i kontakteve mes njerëzve çon drejt ftohtësisë, izolimit, tjetërsimit.

Shembull: marrja e karburantit nga stacioni, tërheqja e parave nga banka.

**1 pikë**                    Nëse gjen një argument.

**DHE**

**1 pikë**                    Nëse një shembull në funksion të argumentit.

**0 pikë**                    Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 9 (a) 3 pikë**

➤ **Paragrafët: I, II**

➤ **Tiparet që i bëjnë rrëfyes:**

- përcaktimi i kohës dhe vendit dhe situatës, ngjarjes;
- prania e protagonistit dhe personazheve të tjerë (autori dhe të tjerët);
- gjuha: foljet në të shkuarën, elementë të medimit.

**1 pikë** Nëse zbulon një paragraf rrëfyes në pjesën e dhënë.

**DHE**

**2 pikë** Nëse identifikon dy tipare që e bëjnë paragrafin e gjetur rrëfyes.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 9 (b) 2 pikë**

➤ **Teknikat:**

- përdorimi i vetës II (njëjës dhe shumës) dhe vetës I (shumës);
- pyetjet retorike;
- mbyllja mbetet e hapur, fton lexuesin të shtojë gjykimin e tij;
- përdorimi herë pas here i një leksiku të shkujdesur, bisedor;
- hyrja e shkurtër, tërheqëse, e fokusuar në një situatë personale, të jetës së përditshme (përvojë jetësore);
- argumentet shoqërohen me shembuj, copëza jete, fakte nga jeta e përditshme;
- toni sugjerues.

**2 pikë** Nëse identifikon dy teknika.

**OSE**

**1 pikë** Nëse identifikon vetëm një teknikë.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 10 1 pikë**

➤ **Shembuj të ironisë:**

- Diçka qesharake ka ndodhur teksa komunikimi evoluon: ne kemi ndaluar së foluri më njëri-tjetrin.
- Të marrësh karburant nga stacioni? Pse t'i thuash mirëmëngjesi shitësit, kur vetëm fusni kartën tuaj bankare tek aparati dhe ia kurseni vetes shqetësimin e kontaktit njerëzor?
- Dëshironi të tërhiqni disa para nga banka? Pse duhet të flisni me nëpunësin e bankës, i cili mund të banojë edhe në lagjen tuaj, kur thjesht mjafton të fusni kartën në bankomat?

**1 pikë** Nëse gjen në tekst një shembull ironie.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 11 (a) 3 pikë**

➤ **Pasoja më e rëndë që sjell përdorimi i teknologjisë:**

Vetmia, tjetërsimi, të ndjerit i huaj në shoqëri (izolimi, moskomunikimi).

➤ **Masat:**

- mospërdorimi celularit;
- asnjë përgjigje me imeil;
- asnjë bisedë telefonike kur është me miq.

**1 pikë** Nëse gjen pasojën më të rëndë që shkakton përdorimi i teknologjisë.

**DHE**

**2 pikë** Nëse identifikon dy masa që autori merr.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 11 (b) 2 pikë**

➤ **Argumentim i plotë**

*Nxënësi duhet të theksojë pasojat e teknologjisë dhe ta mbështesë argumentin me ilustrime nga teksti.*

- Autori mendon se pasojat e teknologjisë po shkaktojnë te njerëzit vetmi, tjetërsimi. Njerëzit jetojnë në shoqëri dhe komunikimi i bën më social, më të dashur, më komunikues si dhe të ndihen më pranë njeri-tjetrit. Por nëse ky komunikim zëvendësohet nga teknologjia atëherë njerëzit do të izoloheshin dhe ndiheshin më të vetmuar. Kjo do t'i bënte më antishoqërore dhe më të huaj për njëri-tjetrin.

Pikërisht në funksion të kësaj ideje autori sjell dhe një sërë shembujsh nga jeta private, si vëzhgimet në park, pamundësia për të folur me miqtë kur ishte në udhëtim, mungesa e komunikimit me fqinjët apo me nënën.

➤ **Argumentim i pjesshëm**

*Nxënësi shpreh një ide por nuk e shtjellon atë dhe nuk e mbështet me ilustrime nga teksti.*

**OSE**

*Nxënësi e shtjellon idenë por nuk e mbështet me ilustrime nga teksti*

- Teknologjia po na largon nga njëri-tjetri.
- Ne po humbasim kontaktet dhe komunikimin me njëri-tjetrin

**2 pikë** Nëse argumenton në mënyrë të plotë mendimin e autorit

**OSE**

**1 pikë** Nëse argumenton në mënyrë të pjesshme mendimin e autorit.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**PJESA II**

**Shekspir**

**Romeo dhe Zhulieta**

<b>Pyetja 12</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 13</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 14</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 15</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 16</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 17</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>

**Pyetja 18**                      **2 pikë**

- Kapuleti ka vendosur ta martojë Zhulietën me Parisin, pasi mendon se Parisi është i përshtatshëm për vajzën e tij: ka pasuri dhe pozitë shoqërore.
- Ai dhe e shoqja mendojnë se martesë është një mjet që të siguron pasurinë, statusin dhe qëndrueshmërinë

**1 pikë**                      Nëse tregon arsyen pse Kapuleti ka vendosur ta martojë të bijën me Parisin.

**DHE**

**1 pikë**                      Nëse shpjegon si e konsideron ai dhe e shoqja martesën.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 19**                      **2 pikë**

- **Arsyeja:** Zhulieta e përdor gjuhën për të fshehur mendimet e saj nga e ëma. Loja e fjalëve që ajo përdor i ruan mendimet e saj private nga të tjerët.
- **Ilustrimi:**

*kur të martohem,/Betohem që më mirë marr Romeon,/Të cilin e urrej,/Sesa Parisin.*

**1 pikë**                      Nëse tregon arsyen pse Zhulieta flet me dykuptime.

**DHE**

**1 pikë**                      Nëse mendimin e ilustron me vargje nga skena.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 20**                      **2 pikë**➤ **Natyra e zonjës Kapulet**

Zonja Kapulet shfaq një mizori të habitshme. Ajo nuk bën asnjë përpjekje për t'u afruar me të bijën apo për të kuptuar ndjenjat e saj. Larg nga të qenit një figurë nëne, ajo është një figurë e ftohtë dhe hakmarrëse. Natyra e saj mizore shfaqet kur është gati që më mirë: *ta martofsha me qefin!* se sa të durojë mosbindjen që Zhulieta shfaq kundrejt saj dhe të shoqit.

**OSE**

Zonja Kapulet shfaqet e ftohtë, e ngurtë. Në fillim duket sikur shqetësohet për të bijën, por kur Zhulieta e refuzon ajo e shmang dhe ia kalon problemin të shoqit: *Ja ku po vjen yt atë e thua ja vetë.*

➤ **Ilustrimi:**

*E marra, që e martofsha me qefin*

**1 pikë**                      Nëse përshkruan natyrën që shfaq Zonja Kapulet.

**DHE**

**1 pikë**                      Nëse përshkrimin e dhënë e ilustron me një shembull nga fragmenti.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 21**                      **3 pikë**

➤ **Tiparet e gjuhës që përdor Kapuleti:** e vrazhdë, nervoze, fyese, agresive, kërcënuese, përbuzëse, urdhëruese.

➤ **Ilustrime:** *Kjo vajzë e padenjë, se ndryshe të zhvarros si qen të ngordhur, kërmë e irnosur! Zuskë! Verdhaçuke, kurrë mos më dil përpara, mos u përgjigj! Pusho! Më hanë duart, Shporru, cipëplasar! Budallaqe, Një kukull çamarroke që tall fatin, Hap sytë dhe mendohu, m'u shporr e lyp e ngordh në rrugë, Për shpirtin tim, të them që s'të njoh më, As gjëja ime s'të përket më ty.*

**2 pikë**                      Nëse identifikon dy tipare që karakterizojnë gjuhë e përdorur nga Kapuleti.

**DHE**

**1 pikë**                      Nëse një nga tiparet e ilustron me një detaj ose varg nga pjesa.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 22**                      **3 pikë****➤ Atmosfera**

Atmosfera e krijuar është dramatike, e tensionuar, agresive, që shkakton frikë, imponim. Çdo fjalë shpreh vullnetin e palëkundur të Kapuletit, i cili në këtë mënyrë kërkon të frikësojë vajzën e tij për mosbindjen e papritur që ajo tregon. Ai arrin deri në ekstrem kur e kërcënon atë se nëse nuk bindet, le të zhduket nga shtëpia, pasi nuk e njeh më.

- **Grupi i fjalëve kyç:** thelbin e kësaj atmosfere e krijojnë sidomos fjalët foljet: *shporr, lyp dhe ngordh*.
- **Funksioni:** Theksojnë vullnetin e palëkundur të Kapuletit, qëndrimin e tij të prerë dhe arbitraritetin ekstrem, po të kemi parasysh se ia drejton së bijës.

**1 pikë**                      Nëse përshkruan atmosferën e krijuar.

**DHE**

**1 pikë**                      Nëse atmosferën e përshkruan bazuar në tri fjalët kyç që japin thelbin e saj.

**DHE**

**1 pikë**                      Nëse tregon cili është funksioni që fjalët luajnë në tërësinë e skenës.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 23**                      **2 pikë****➤ Marrëdhëniet ne familjen Kapulet:**

- Bashkëbisedimi midis Zhulietës dhe prindërve, konfirmon mungesën e komunikimit, të mirëkuptimit. Shqetësimi i tyre i vetëm është një martesë që përmirëson pasurinë dhe statusin e tyre shoqëror dhe jo lumturinë e vajzës së tyre.

**OSE**

- Marrëdhënie moskuptimi, arbitrariteti, dhune psikologjike. Në familjen Kapulet dominon autoriteti i burrit, babait, bashkëshortit. Kapuleti tërbohohet kur urdhrat e tij shkelen.

**➤ Ilustrimi:**

*Ja ku po vjen yt atë e thuaja vetë./Dhe vetë shihe si do ta marrë; S'ia the, moj grua, ti vendimin tonë? Kjo vajzë e padenjë, që i gjetëm/Një burrë kaq të denjë e bujar?*

**1 pikë**                      Nëse tregon natyrën e marrëdhënieve në familjen Kapulet.

**DHE**

**1 pikë**                      Nëse mendimin e ilustron me vargjet e duhura nga fragmenti.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 24 2 pikë**

➤ **Të dhënat:**

- Agresiviteti i prindërve, palëkundshmëria e tyre;
- Parashikimet ogurzeza të Zonjës Kapulet: Zhuljeta më mirë të martohet më varrin (siç dhe ndodh bashkimi i tyre tragjik në varr);
- Është vetë Zonja Kapulet që me mallkimet e saj sikur e parashkruan fatin e së bijës;
- Marrëdhënia e Zhuljetës me babanë, agresiviteti i tij dhe mungesa e dialogut midis tyre;
- Paralajmërimi se ka veç dy rrugë: o martesë o rruga e madhe;
- Mjedis i zyrtër, me gjuhë urrejtje që s'paralajmëron veç fund tragjik;
- Gjuha e përdorur nga Kapuletët krijon efekte shumë dramatike: mallkime, fjalë të rënda, fyerje, kërcënime.

**2 pikë** Nëse identifikon në skenë dy të dhëna që paralajmërojnë fundin e dy të rinjve.

**OSE**

**1 pikë** Nëse identifikon vetëm një të dhënë.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 25 8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

**KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË 2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton nëse është dakord ose jo me pohimin e dhënë;
- mban qartë një pozicion të dukshëm në zgjedhjen e bërë;
- përdor shembuj dhe arsye specifike për të mbështetur përgjigjen e dhënë, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të tjerëve;
- ka qartësi mendimi.

**KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË 2 pikë**

**1 pikë Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
  - hyrjen;
  - zhvillimin;
  - përfundimin.

Nxënësi merr **1 pikë**, nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

**1 pikë Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

**KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI**

**2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë;
- shprehet me një gjuhë eseistike;
- ka fjalor të pasur;
- ka stil origjinal.

**KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE**

**2 pikë**

**(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore;
- ndërton fjali të sakta dhe të qarta;
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm;
- ka saktësi drejtshkrimore.